

Data 10.03.2025.

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës "Shefqet Ndroqi", ndarë me dy lote: loti 1: "Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë" dhe loti 2 "Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë"- Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
905244200-0 / Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore.

VLERA E FONDIT LIMIT: 121,310,466.67(njëqind e njëzet e një milion e treqind e dhjetë mië e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lek pa TVSH** e konvertuar në Euro 99.27 sipas kursit të këmbimit të datës **10.03.2025** ku 1,222,025.45 (nje milion e dyqind e njezet e dy mije e njezet e pese pike dyzet e pese) **Euro pa TVSH.E ndare në dy lote ku:**

Loti 1 Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë

Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave i parashikuar për periudhën 48 (dyzet e tetë) mujore është: 117,209,466.67(Njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH** e konvertuar në Euro 99.27 sipas kursit të këmbimit të datës **10.03.2025** ku **1,180,713.88** (nje milion e njeqind e tetedhjetë mije e shtateqind e trembedhjetë pike tetedhjetë e tete) **Euro pa TVSH**

Loti 2 Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë

Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave i parashikuar për periudhën 48 (dyzet e tetë) mujore është: 4,101,000(katër milion e njëqind e një mijë)lekëpa **TVSH** e konvertuar në Euro 99.27 sipas kursit të këmbimit të datës **10.03.2025** ku 41,311.57 (dyzet e nje mije e treqind e njembedhjetë pike pesedhjetë e shtate) **Euro pa TVSH**

Lot 1 Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë

Shumatorja e çmimeve për njësi për lotin 1: 1168.58 (njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetëpikë pesëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.** e konvertuar në Euro 99.27 sipas kursit të këmbimit të datës **10.03.2025** ku **11.77**(njembedhjetë pike shtatedhjetë e shtate) **Euro pa TVSH**

Lot 2 Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavaje

Shumatorja e çmimeve për njësi për lotin 2: 1025.25(një mijë e njëzet e pesë pikë njëzet e pesë) Lekë pa TVSH e konvertuar në Euro 99.27 sipas kursit të këmbimit të datës 10.03.2025 ku 10.33 (dhjete pike tridhet e tre) Euro pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor QSRT ”Shefqet Ndroqi”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

loti 1-“Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;*
- b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Pika 2.1.1. Operatori Ekonomik duhet të disponoje Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjësimit të jetë sterilizim me Autoklavim ose teknologji ekuivalente

Pika 2.1.2. Operatori ekonomik duhet të disponoje Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe liçencë Profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 08 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.

1. Argumentimi per Pika 2.1.1 dhe Pika 2.1.2:

Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 495/___ prot.,date 06.02.2025 për procedurën e prokurimit me **Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Qendrën Spitalore Rajonale tëTiranës "Shefqet Ndroqi", ndarë me dy lote: loti 1: "Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë" dhe loti 2 "Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë"-Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj"**, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.495 prot, datë 30.12.2024 dhe nr.495/1 prot, datë 30.12.2025 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu, Kërkesat e mëposhtme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", si dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011, "*Për mbrojtjen e mjedisit*", ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 "*Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme*", ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "*Per lejet e mjedisit*" i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 "*Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta*", ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqiperise*" i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, "*Per menaxhimin e integruar te mbetjeve*" te ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 "*Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve eSpitalore"*", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, dt.18 shkurt 2005 "*Per miratimin e katalogut shqiptar te mbetjeve*"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, date 26.05.2009, "*Per licensat dhe lejet, qe trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa*" e ndryshuar, Udhëzuesin Kombëtar "*Per Menaxhimin e Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore*" dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhzuesin Kombetar "*Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore*" ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*". **Referuar Katalogut Shqiptar të Mbetjeve**, të miratuar me VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "*Për miratimin e katalogut të mbetjeve*, këto mbetje janë konsideruar si Kod 18.01.02 dhe 18.01.03, metoda më e mirë dhe më efikase për të pasur një mbrojtje maksimale dhe për të shmangur pasojat qoftë mjedisore qoftë në popullatë, është metoda me hidrokavim/autoklavim dhe incenerim. Nisur dhe nga vetë titulli i procedurës që është: **Trajtim dhe Asgjësim...**referuar VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 "*Për Lendfilllet e Mbetjeve*", Pika II/f) ku citohet që: f) "*Trajtim*" nënkupton proceset (fizike, termike, kimike ose biologjike, përfshirë edhe ndarjen) të cilat

ndryshojnë karakteristikat e mbetjeve me qëllim që të pakësojnë vëllimin dhe natyrën e rrezikshme të tyre, të lehtësojnë trajtimin ose të rrisin rikuperimin e tyre..., pra nevojitet trajtimi dhe më pas asgjësimi final i tyre

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Pika 2.2.1: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2021; 2022; 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 100% e fondit limit për lot 1 për të cilin oferton të kësaj Proçedure Prokurimi.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, konkretisht mbi vlerën e përcaktuar në piken 2.10. /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera e xhiros minimale do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedurë, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te percaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbimkonsulence".

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo me e vogel se 100 % e vlerës së fondit limit*, për të cilë konkurren operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrisë te Financave ne zbatim te këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhës.

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2024.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;** si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për

Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **100 % e vlerës së fondit limit.vlerës së pritshme të kontratave për të cilat konkurron operatori, eshte nje dëshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operoret Ekonomike ofertues zotërojnë kapacitete ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK. Përcaktimi i nga AK i kësaj kërkesë, lidhet me natyrën sensitive të shërbimit në kontekst të shëndetit publik dhe mjedisit, ndaj nga OE kërkohen parametra të lartë besueshmërie. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Pika 2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor). **(nuk është i aplikueshëm)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese). **(nuk është i aplikueshëm)**

2.3 Kapaciteti teknik:

Pika 2.3.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave **per lot 1**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 35 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik" , ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të Kontratave, vlere e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkohet që OE të vërtetojnë aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK, referuar LPP dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

"3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit."

Eshtë kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën **minimumi 35% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për të cilent oferton Operatori Ekonomik**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Autoriteti Kontraktor QSRT “Shefqet Ndroqi” është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet pervojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Pika 2.3.2:

a.) Operatori duhet të ketë çertifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b.) Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c.) Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë”** ose **ISO 45001:2023 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

d.) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e sterilizimit dhe incenerimit të lëshuar nga ISHSH (Inspektoriat Shëndetësor Shtetëror).

Argumentimi për Pikat 2.3.2 nën-pika: a; b; c; d: Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter u vendos në mbështetje të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 495/___ prot., datë 06.02.2025 për procedurën e prokurimit me Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, ndarë me dy lote: loti 1: “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë” dhe loti 2 “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë”- Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.495 prot, datë 30.12.2024 dhe nr.495/1 prot, datë 30.12.2025 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Kavajës, dhe u miratua nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike. Ky kriter u vendos në përputhje me germen “c”, të pikes 1 të nenit 77 të Ligjit

nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, në pikën 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet dokumentacionit vërtetues, që tregojnë se kushtet janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK. Parashikimi i regjistrimit të procesit të punës nga OE garanton zbatimin e plotë të kontratës së shpallur nga AK si dhe shmang mundësinë e abuzimit me zbatimin e kontratës.

Pika 2.3.2, Shkronja ”d”: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, ”Për lejet e mjedisit” i ndryshuar dhe në VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar”, ku parashikohet shprehimisht: ".....10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë."

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Pika 2.3.3: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Kërkohej që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 10 (dhjetë) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët dy nga punonjësit duhet të jenë minimumi: një inxhinjer mjedisi dhe një inxhinjer kimik, 2 (dy) shofera për dy makina, 1 (një) administrator dhe 5 (pesë) punonjës mbështetës për ngarkimin/shkarkimin dhe përpunimin e mbetjeve), me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku të pasqyrohen minimumi 10 - dhjetë punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe

- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

▪ Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

-Minimumi 1 (një) Inxhinjer Mjedisori

-Minimumi 1 (një) Inxhinjer Kimik

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

– CV përkatëse;

– Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit për secilin inxhinjer;

– Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinjerin e mjedisit dhe inxhinjerin kimik.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi pika 2.3.3:

Ky kriter u vendos në mbështetje të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 495/___ prot., date 06.02.2025 për procedurën e prokurimit me **Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, ndarë me dy lote: loti 1: “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë” dhe loti 2 “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë”- Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj”**, nga Komisioni i argumentimit, bashkëlidhur kërkesave nr.495 prot, datë 30.12.2024 dhe nr.495/1 prot, datë 30.12.2025 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 41/4 b i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu, dy inxhinjerët janë vendosur të kërkohen nga AK me argumentimin se këto mbetje konsiderohen të një rrezikshmërie të veçantë pasi përbëhen nga mbetje spitalore (artikuj) ashtu edhe nga

anatomike dhe nevoja e të dy inxhinjerëve nevojitet për të dëshmuar OE që i ka të gjitha kapacitetet dhe personat specialistë për asgjësimin e këtyre mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter është vendosur pas argumentimit të Komisionit të Specifikimeve Teknike: nisur edhe nga fakti që janë mbetje të rrezikshme spitalore, dhe anatomike (pjesë postoperacionale nga trupi i njeriut), u vendos përcaktimi i këtij kriteri, pasi nevojitet prania e një inxhinieri mjedisi dhe kimist, sidomos për mënyrën e përpunimit të këtyre mbetjeve dhe më pas depozitimin e tyre në vendin e përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

Nisur nga proceset që realizohen gjatë fazes së evadimit si :grumbullimi,transportimi , deri në fazën finale të depozitimit në landfill si dhe asgjësimin lind nevoja që OE të ketë minimum 5 punonjës mbështetës.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Pika 2.3.4: “ Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë *ne pronesi ose me qera minimalisht 2 (dy) mjete që transporton mbetjet spitalore, sipas kërkesave të Nenit 23 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe Shtojcës 4 të VKM Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja) si dhe në zbatim të Pikës 9.3.3 (Automjetet/anjët e grumbullimit) të Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.*

- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

➤ Për automjetin në pronësi: *Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto të mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese. Automjetet e perdorura duhet qe te plotësojnë karakteristikat e mjetit, të bazuara në piken 8.8/c dhe shtojcës 4, të VKM nr.798, datë 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, ” Per administrimin e mbetjeve spitalore”si edhe pike 9.3.3 të Udhëzuesit Kombëtar ”Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.*

➤ Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt – Miratimet Higjenosanitare. Automjetet e përdorura duhet qe te plotësojnë karakteristikave të mjetit të bazuara në piken 8.8/c dhe shtojcës 4, të VKM nr.798, datë 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, ”Administrimin e mbetjeve spitalore”si edhe pike 9.3.3 të Udhëzuesit Kombëtar ”Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë automjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e automjeteve të nevojshme për realizimin e shërbimeve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”*

Argumentimi per Kriteri 2.3.4:

Ky kriter u vendos ne mbështetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 495/___ prot.,date 06.02.2025 për procedurën e prokurimit me Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Qendrën Spitalore Rajonale tëTiranës ”Shefqet Ndroqi”, ndarë me dy lote: loti 1: “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Tiranë” dhe loti 2 “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Njësinë Kavajë”- Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj””, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.495 prot, datë 30.12.2024 dhe nr.495/1 prot, datë 30.12.2025 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Meqënëse shërbimi objekt kontrate, parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK, në ambientet e trajtimit të OE, dhe te produkti final nga ambientet e OE ne landfill, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion automjetet për të përmbushur elementet e kontratës (transportin), të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

